Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0590

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Adnan A. Bala B.I.", kundër Njoftimit per kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje mjekësore" me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Spitali "SHEIKH ZAYED", më 26/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Adnan A. Bala" B.I. me nr. 2023/0590, e datës 16/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje mjekësore", me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Spitali "SHEIKH ZAYED".

2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje mjekësore", me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Spitali "SHEIKH ZAYED". Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Spitali “SHEIKH ZAYED” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 07.07.2023, ka paraqitur Njoftimin për kontratë- B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me paisje mjekësore” me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1. Afati për dorëzimin e ofertave me datën 18.08.2023.

Me 12.08.2023, OE "Adnan Bala" B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 15.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Adnan Bala" B.I i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me 16.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 590/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 11.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet vendimi i AK-së dhe të bëhet zgjatja e afatit për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet pjesërisht me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e

palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Pretendimet e Ankuesit "Adnan Bala" B.I

- *Pretendimi i parë (I)*- Pretendimet ankimore se specifikimet teknike te detyrueshme i janë përshtatur ne tërësi një prodhuesi te caktuar dhe kjo është kundërshtim me Nenin 28 dhe 7 te LPP-se, sepse janë specifika favorizuese dhe diskriminuese për prodhues tjerë dhe OE qe shprehin interes për ofertim përmes procedurës se hapur qe është qëllimi konkurrence dhe trajtim i barabarte. Ne sqarime e dhëna nga AK nuk jep mundësi OE tjerë pjesëmarrje te tender. LOT 2 - Furnizim me pajisje mjekësore. Pozicioni 2- GPS postural lab - Aparat për ekzaminim dhe analizimin e postures për analize statike në planin frontal dhe sagjital të trupit si dhe për mbështetjen podalike. Specifikime teknike te detyrueshme për GPS postural lab - Aparat për ekzaminim dhe analizimin e postures për analize statike në planin frontal dhe sagjital të trupit si dhe për mbështetjen podalike janë favorizuese për ndonjë OE te caktuar sepse te gjitha parametrat teknike te kërkuara ne dosje te tenderit i përputhen ne tërësi produktit- modeli e cekur me poshtë, Pra jane vetëm kopy/past.
- *Pretendimi i dytë (II)*- Pozicioni 3 dhe 4 janë te prodhuesit Turmed pra janë vetëm kopy/past, Pozicioni 4 nga AK dhe pozicionin 4 nga Prodhuesi identike.
- Pretendimi i tretë (II)- Specifikim teknike te detyrueshme për pozicioni 2 janë favorizuese për një OE te caktuar sepse te gjitha parametrat teknike te kërkuara ne dosje te tenderit i përputhen ne tërësi produktit- e cekur me lartë. Pra AK ka cek ne Sqarim citim" Referojuni DT" pra është e pa mundur te ofertohet sepse AK ka favorizuar këtë prodhues edhe prodhuesi ka thënë vetëm një autorizim për Kosove kurse asnjë dilier tjerë nuk ka te drejt te jepin autorizim për Kosove. Edhe pozicion tjera si 5 ,6 dhe 7 janë te përpiluar për prodhuesit e caktuar pra janë identike. Neni 7 –Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi-Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 28 te LPP-se Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për këto pozicione, bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik". Gjithashtu ky përpilim teknike nga njësia e kërkesës është diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrimi ne raport me kushte teknike te konkurrencës/trajtim i barabarte pra specifikacionet teknike duhet të përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese. Si pale me interes material për ketë aktivitet te prokurimit kërkojmë nga njësia e kërkesës te modifikoj specifikimet teknike te detyrueshme për këtë furnizim, ne mënyre qe te mundësohet konkurrenca ne mes prodhueseve për produktin qe ju kërkoni, pasi qe kjo është procedure e hapur dhe qëllimi i Autoritetit kontraktues sipas LPP-se është trajtimi i barabarte i OE pjesëmarrës për te arritur qëllimin- Parimin e Ekonomicitetit. Andaj ky parim arrihet vetëm kur termat teknike si ne rastin ne fjalë qe te mundësoj konkurrence maksimale ne mes Operatoreve ekonomik dhe jo kur

paraprakisht dihet se cilin prodhues dhe produkt do shpallen fitues për tender. Pra me këto specfikacione teknike siç janë tani është e pa mundur OE tjerë te marrin pjese sepse AK ka përpiluar specfikacion teknike ne atë mënyrë qe OE i favorizuar ka te garantuar qe do te fitoj dhe do rekomandohet për kontrate këtë tender pa marr parasysh çmimin e ofertës.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

- *Konstatimi i parë (I)*- Eksperti shqyrtues/ teknik, sqaron se OE ankues "Adnan A. Bala B.I.", ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me kërkesat e vendosura ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, për te cilat i njëjti ka kërkuar kërkesa për informacione shtesë për Lot 2 dhe Lot 3, lidhur me kërkesat për te cilat ka kërkuar sqarime, ka marr përgjigje negative dhe i njëjti parashtron ankese ne OSHP, me pretendimin se kërkesat janë favorizuese dhe diskriminuese për OE-te te cilët shprehin interes për ketë aktivitet të prokurimit. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-se. Eksperti teknik sqaron se, OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore te LPP-se. Eksperti teknik, pasi ka analizuar dëshmitë e ofruara nga OE ankues vlerëson se ne pozicionet 1 dhe 2 specifikacionet i janë përshtatur prodhuesit Aspel. Po ashtu pozicionet 3 dhe 4 i janë përshtatur prodhuesit Turmed, pra modelin 4-shtretër për paciente të urgjencës TM C-3033. Gjithashtu edhe pozicionet 5,6,7 janë përpiluar për prodhuesit e caktuar si me larte dhe i janë përshtatur këtij prodhuesi. Eksperti teknik, vlerëson se pretendimet e OE ankues qëndrojnë për pozicionin 1.2.3.4.5.6.7 dhe se këto kërkesa duhet te hiqen nga dosja e tenderit, për faktin se i janë përshtatur prodhuesit Aspel dhe Turmed. Eksperti shqyrtues/ Teknik si sqarim shtese i rekomandon AK-se qe gjate përmirësimit te kërkesave te dosjes se tenderit të veproj ne harmoni me Nenin 53.7 të LPP-se.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe vlerëson se ankesa e OE "Adnan Bala B.I" është e bazuar.

Në fakt Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e këtij rasti Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka hartuar specifikat e dosjes së tenderit duke hartuar specifika që në parim mund të jenë diskriminuese sepse për pozicionet 1 dhe 2 specifikacionet i janë përshtatur prodhuesit Aspel. Po ashtu pozicionet 3 dhe 4 i janë përshtatur prodhuesit Turmed, pra modelin 4- shtretër për paciente të urgjencës TM C-3033. Gjithashtu edhe pozicionet 5, 6, 7 janë përpiluar për prodhuesit e caktuar si me larte dhe i janë përshtatur

këtij prodhuesi.

Paneli shqyrtues në vlerësimin e tij të pavarur, konsideron se pretendimet e OE ankues qëndrojnë për pozicionet e referuara duke u bazuar në raportin e ekspertes teknike dhe asaj profesionale, ndërsa AK obligohet që përmirësimet ti bëjë konform legjislacionit në fuqi, duke mundësuar ekuivalencë produktesh konform nenit 28 të LPP-së, duke siguruar që produktet në specifikat ku është e mundur të kenë tolerancë plotësimi duke saktësuar minimumin dhe maksimumin e lejuar kështu që specifikat e vendosura rrjedhimisht të devijojnë mundësinë e diskriminimit të OE-ve pjesëmarrës si dhe ngushtimin e konkurrencës.

- *Përfundim-*

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së dhe obligon AK-ne qe gjate përmirësimit te kërkesave te dosjes se tenderit të veproj ne harmoni me nenin 53.7 të LPP-se. Paneli Shqyrtues në çdo rast pret që autoritet kontraktuese të veprojnë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar. Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhenatyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde e poashtu ka konsideruar se përgjigjja në kërkesën për rishqyrtim ka qenë e mangët dhe jo e arsyetuar konform nenit 108/a të LPP-së, për me tepër edhe ligji i procedurës administrative, konkretisht Neni 48 i LPPA-së, parasheh se: *"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ"*. në rastin konkret paneli konsideron se arsyetimi nuk ka përmbajtur këto dispozita të nenit relevant:*1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;* andaj në këtë rast konsiderohet se aplikohet pika: *2. Një arsyetim qe është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

Paneli shqyrtues thekson se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SPITALI SHEIKH ZAYED**
- OE - **Adnan A. Bala B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: